




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur nenit 13, të Rregullores Nr. 01-110/04-14194, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim për më pak se një (1) të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Raportit final të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronë së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës së Gjakovës lidh këtë:

K O N T R A T Ë

Për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës së Gjakovës

E hartuar me datën 14.03.2022 në Gjakovë, lidhur në mes të palëve kontaktuese, si më poshtë:

PALËT KONTRAKTUESE:

- 1. Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Gjakovës i cili e përfaqëson Komunën,** si dhënës i pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim për më pak se një (1) vit nga njëra anë dhe
- 2. Çlirim Avdullahu – përfaqësues i “Çlirim Avdullahu” B.I nga Komuna e Gjakovës,** me numër të biznesit 810110205, përfitues - shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës, nga ana tjetër.

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, të pronës së paluajtshme të Komunës së Gjakovës, për hapësirat e bifës së administratës së komunës për shfrytëzim me karakter biznes sipas kërkesës së prezantuar nga pala.



Neni 2

Kohëzgjatja e kontratës

Palët kontraktuese janë pajtuar që afati i shfrytëzimit të hapësirës së lartcekur të jetë deri me datën 30.09.2022, nga data e nënshkrimit të kontratës. Në rastin kur ndodh bartja e administratës së Komunës në objektin e ri do të ndërpritet kjo kontratë.

Pas kalimit të afatit të paraparë në pikën 1, të nenit 2, të kësaj kontrate ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet pronarit Komunës së Gjakovës.

Neni 3

Lartësia e çmimit dhe afati i pagesës

1. Çmimi për periudhën **mujore** është caktuar në vlerë prej 200€.
2. Shfrytëzuesi obligohet që pagesën për hapësirën e marrë në shfrytëzim ta paguaj në xhirollogarinë e Komunës së Gjakovës, në fillim të çdo muaji, prej datës 01 më së largu deri më 05 të muajt vijues.
3. Në rast të mos pagesës së borgjit, ndaj shfrytëzuesit do të merren masa ndëshkimore, sipas procedurave ligjore në fuqi, duke e llogaritur edhe kamatën.
4. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë nga qiramarrësi.

Neni 4

Dhënia e pronës së paluajtshme dhe mënyra e shfrytëzimit

1. Komuna garanton se objekti i kësaj kontrate nuk ka të meta juridike.
2. Shfrytëzuesi nuk mund t'a ndryshojë ushtrimin e veprimtarisë së vet, por pronën që e ka marrë në shfrytëzim duhet ta shfrytëzojë vetëm për qëllimin e kërkuar ashtu siç e ka të paraparë më këtë kontratë.
3. Shpenzimet e energjisë elektrike nxemjes, dhe komunalit do të mbulohen nga komuna.
4. Në byfe ndalohet përdorimi/shërbimi i pijeve alkoolike dhe të duhanit.
5. Çmimet dhe shërbimet të jenë të arsyeshëm për shërbyesit.

Neni 5

Mbikëqyrja e kontratës

1. Prona e paluajtshme nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Komuna e Gjakovës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i bartet personit të tretë në shfrytëzim, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

2. Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative mbikëqyr realizimin e kësaj kontrate.

Neni 6

Shkëputja e njëanshme e kontratës

1. Shkëputja e kontratës në mënyrë të njëanshme bëhet në rast të mospërbushjes së obligimeve, nga shfrytëzuesi i pronës së paluajtshme, siç është përcaktuar në këtë kontratë.
2. Në rast të shkëputjes së kontratës para kalimit të afatit, me marrëveshjen e palëve kontraktuese, obligimet e mbetura do të rregullohen me marrëveshje të veçantë mes palëve kontraktuese, por duke e lajmëruar njëra-tjetrën që dëshiron ta shkëpus kontratën në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, para se ta lirojë pronën e marrë me qira.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj kontrate dhe në rast të mosmarrëveshjes eventuale ndërmjet palëve kontraktuese, palët do të i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje në mes të palëve, atëherë kontesti do të zgjidhet në Gjykata kompetente.

Neni 8

Kopja e kontratës

Kjo kontratë është përpiluar dhe nënshkruar në 3, (tri) kopje të njëjta identike prej të cilave nga 1, (një) kopje i takojnë secilës palë kontraktuese, kurse (1) një në Drejtorin përkatës.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

PALËT NËN SHKRUESE

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

Çlirim Avdullahu

Çlirim Avdullahu B.I